



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“FRUTIKULTURË”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

H1-III-19

Tiranë më, Qershor 2019

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Frutikulturë”			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	H1-III-19
Qëllimi:	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “Frutikulturë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për në sektorin e frutikulturës për kultivimin dhe prodhimin e pemëve drufrutore, ullirit, agrumeve dhe hardhisë, duke zbatuar me përpikmëri hallkat agroteknologjike. Ky kualifikim profesional mundëson rritjen e alternativave për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me frutikulturën, si dhe zhvillimi i personalitetit të individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Frutikulturë” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> – kanë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. – zbatojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara nga institucionet e arsimit dhe formimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Frutikulturë”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Supplementin përkatës, që përkon me nivelin e punonjësit të kualifikuar në këtë fushë profesionale në tregun e punës,</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës, <i>brenda dhe jashtë vendit</i>, me drejtim frutikulturë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • prodhim fidanësh të pemëve frutorë, ullinj, agrume dhe hardhisë; • të shërbyer në pemëtoret e prodhimit; • të shërbyer në sektorin privat shtëpiak në zonat urbane dhe rurale; • vetëpunësim në fermën e tij vetjake. <p>Në përfundim të këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	H-II-01-14			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT:

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin “Frutikulturë” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Pemët frutore, ulliri dhe agrumet

- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike, sociale dhe bujqësore që ka sot kultivimi i kulturave drufrutorë në ekonominë e vendit tonë;
- Të përshkruajë përhapjen e kulturave frutore, farore, bërthamore (mollë, dardhë, ftua, nespulla etj.) sipas zonave klimatiko-tokësore të vendit tonë;
- Të përshkruajë përhapjen e kulturave frutore (hurma, shega, mani, hidja etj.) sipas zonave klimatiko-tokësore;
- Të përshkruajë përhapjen e kulturave frutore arrore (arra, bajamja, lajthia, gështenja) sipas zonave klimatiko-tokësore;
- Të përshkruajë përhapjen e kulturave frutore subtropikale (ulliri, agrumet) sipas zonave klimatiko-tokësore dhe perspektiva e kultivimit të tyre;
- Të shpjegojë përhapjen e frutave të vogla (luleshtrydhe, mjedra, boronica, manaferra etj.) sipas zonave klimatiko-tokësore, si dhe perspektiva e kultivimit të tyre;
- Të shpjegojë konceptin e prodhimit periodik dhe masat për mënjanimin e tij;

Faktorët ekologjikë në ndikimin e prodhimit të pemëve frutore

- Të përshkruajë rolin e faktorëve ekologjikë (klimë, tokë etj.) në efektshmërinë e prodhimit;
- Të shpjegojë ndikimin e temperaturës ajrore dhe tokësore si faktor bazë për shtrirjen e pemëve frutore në territorin e vendit tonë;
- Të shpjegojë ndikimin e lagështirës në rritjen e zhvillimin normal gjatë ciklit bimor të pemëve frutore dhe masat për mënjanimin e ndikimit negativ;
- Të shpjegojë rolin e ndriçimit në rritjen e pemëve dhe masat që merren për një ndriçim sa më të mirë të pemëve frutore;
- Të shpjegojë ndikimin e ajrit në jetën dhe prodhimtarinë e pemëve frutorë, si dhe masat që merren për mënjanimin e erërave të forta;
- Të shpjegojë rolin e faktorëve tokësorë në përhapjen dhe zhvillimin e pemëve frutore (strukturë, pH, thellësi tabani, pjellori e tokës, relievi dhe kundrejtimi);
- Të klasifikojë pemët frutore sipas qëndrueshmërisë ndaj reaksionit të tokës (pH);
- Të shpjegojë rolin e gjallesave në jetën dhe prodhimtarinë e pemëve frutore;
- Të përshkruajë dukurinë e “lodhjes së tokës” dhe masat për mënjanimin e kësaj dukurie;

Mjetet dhe pajisjet e punës

- Të përshkruajë mjetet e punës që përdoren për punimin e tokës në pemëtari;

- Të rendisë veglat pajisjet dhe materialet e nevojshme për shartim drufrutorëve ;
- Të listojë veglat pajisjet dhe materialet e nevojshme për krasitjen e drufrutorëve ;
- Të rendisë pajisjet dhe materialet e nevojshme që përdoren në trajtimin kimik të drufrutorëve ;
- Të rendisë mjetet që përdoren për çdo proces përpunimi frutave ;

Teknologjia e shtimit të pemëve frutore

- Të shpjegojë bazat biologjike të shumimit të pemëve frutore;
- Të listojë anët pozitive dhe negative të shtimit me farë dhe me pjesë vegetative;
- Të rendisë faktorët e mjedisit që ndikojnë në shtimin vegetativ;
- Të shpjegojë teknikën e shtimit natyror, si dhe pemët ku zbatohet;
- Të shpjegojë mënyrat e shtimit artificial me copa (të drunjëzuara, gunga, kamza, lastunja, margota, përparja);
- Të shpjegojë teknikën e shartimit dhe dallimin nga shtimi vegetativ me copa;
- Të shpjegojë kushtet që duhen plotësuar dhe masat agroteknike për zënien e mirë të pjesëve të shartuara;
- Të shpjegojë rregullat që duhen zbatuar në zgjedhjen e nënshartesës dhe mbishartesës;
- Të përshkruajë llojet e nënshartesave dhe mbishartesave sipas kërkesave themelore të përzgjedhjes së tyre;
- Të shpjegojë hallkat teknologjike në procesin e bashkimit të nënshartesës dhe mbishartesës.
- Të shpjegojë teknikën e shartimit me syth të fjetur, të zgjuar, dyfish dhe unazë;
- Të shpjegojë dallimet midis llojeve të ndryshme të shartimit me syth si dhe pemët në të cilat gjen zbatim;
- Të shpjegojë teknikat e shartimit me kalem (me çarje të plotë, me çarje anësore, nën lëvore, koopulim në formë ure);
- Të shpjegojë shërbimet që i kryhen bimëve të porsa shartuara, për të dhënë një bimë të re të shëndetshme;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e korrigjimeve të shartimeve të gabuara;

Fidanishtja e pemëve frutore

- Të rendisë kushtet klimatike dhe teknologjike për ngritjen e fidanishtes;
- Të shpjegojë hallkat teknologjike për prodhimin e fidanëve frutorë;
- Të shpjegojë konceptin, rëndësinë dhe rolin e sektorit të pemëtores mëmë të (nënshartesave dhe mbishartesave);
- Të rendisë kushtet që duhet të plotësojë vendi ku do të mbillet nënshartesa;
- Të rendisë sektorët kryesorë të realizimit të fidanëve, si dhe rolin e secilit sektor (mëmë, shtimit, formimit);
- Të shpjegojë prodhimin e nënshartesave me farë në pemët frutore, agrume, ullishta;
- Të shpjegojë cilësitë që duhet të ketë fara që përdoret për nënshartesë;
- Të shpjegojë hallkat teknologjike të përgatitjes së farës (nxjerrja, tharja, zgjedhja, ruajtja, shtratifikimi dhe mbjellja në farishte);
- Të shpjegojë shërbimet në farishte pas mbjelljes së farës;

- Të shpjegojë rëndësinë e zgjedhjes së sektorit mëmë për marrje kalemash për mbishartesë;
- Të shpjegojë organizimin e sektorit të shtimit sipas mënyrës dhe qëllimit të shtimit;
- Të shpjegojë organizimin e sektorit të formimit ose shartesores sipas viteve që mbahen fidanët në shartesore;
- Të përshkruajë shërbimet agroteknike në shartesoren e vitit të parë, të dytë, dhe të tretë;
- Të shpjegojë teknikën e shkulljes dhe klasifikimit të fidanëve të prodhuar me farë;
- Të përshkruajë kushtet që mbahen parasysh për shtratifikimin e fidanëve;
- Të shpjegojë elementët e procesit të etiketimit, ambalazhimit dhe transportit të fidanëve;
- Të shpjegojë prodhimin e nënshartesave me pjesë vegjetative të pemëve frutore, ullirit dhe agrumet;
- Të shpjegojë hallkat teknologjike të shartesoreve të vitit të parë, të dytë dhe të tretë të prodhuara me pjesë vegjetative të pemëve frutore dhe ullirit;
- Të shpjegojë teknikën e shkulljes, zgjedhjes, klasifikimit, shtratifikimit, etiketimit dhe ambalazhimit e transportit të fidanëve të pemëve frutorë të prodhuar me pjesë vegjetative;
- Të listojë nënshartesat që përdoren në vendin tonë në pemët frutore, ullirit, agrumeve etj.;
- Të diferencojë mënyrën e prodhimit të fidanit të ullirit nga ajo e prodhimit të fidanëve të pemëve frutore;
- Të shpjegojë teknikën e formimit të kurorës së pemëve frutore;
- Të përshkruajë sëmudjet që prekin fidanët frutore në fidanishte;
- Të përshkruajë librin e fidanishtes në fushë dhe zyrë;

Krijimi i pemëtoreve të reja

- Të shpjegojë elementët e projektit teknik (masat organizative, teknike dhe ekonomike) që zbatohen, për ngritjen e blloqeve të reja me pemëtore;
- Të përshkruajë ndikimin e faktorëve klimatikë dhe tokësorë në ngritjen të pemëtoreve të reja;
- Të rendisë elementët kryesorë të organizimit të territorit;
- Të përshkruajë sistemimin sipërfaqësor në krijimin e bllokut të pemëtoreve;
- Të përshkruajë hapat teknologjike të punimeve para mbjelljes së fidanit;
- Të rendisë sistemet e mbjelljes së pemëve (katrorë, trekëndësh, katërkëndësh dhe vijave rrushkulluese);
- Të përshkruajë mënyrën e piketimit të tokës në formë katrori, trekëndëshi, katërkëndëshe dhe vijave rrushkulluese, në përshtatje me kushtet klimatiko-tokësore të zonës ku ngrihet blloku i pemëtoreve, ullishtave etj.;
- Të përshkruajë procesin e punës së mbjelljes së pemëve të reja, si dhe shërbimet menjëherë pas mbjelljes;

Agroteknologjia e pemëtoreve të reja

- Të shpjegojë rëndësinë e kujdesit të pemëtoreve të reja në vitet e para;
- Të shpjegojë mënyrat e mbajtjes së tokës në pemishte në vitet e para pas mbjelljes (ugar, livadh, mulçerim etj.);
- Të shpjegojë arsyet e bashkëshoqërimit të pemëtoreve me bimë të tjera, si dhe bashkëshoqërueset më të përshtatshme, sipas llojit të pemëve;

- Të përshkruajë mënyrat e punimit të tokës në pemëtore sipas sistemit të mbajtjes së tokës (livadh, ugar etj.) dhe kohës së kryerjes së tyre (pranverë, verë, vjeshtë), thellësisë etj.;
- Të shpjegojë mënyrat e luftimit të barërave të këqija me punim toke, shkulle dhe herbicide;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e përdorimit të kufizuar të herbicideve në ruajtjen e tokës nga ndotja kimike ;
- Të përshkruajë dëmet që shkaktojnë llojet e herbicideve gjatë përdorimit;
- Të përshkruajë sistemin e plehërimit organik, mineral dhe të gjelbër në pemëtore;
- Të shpjegojë mënyrat e ujitjes (me infiltrim, me tava, shiu dhe me pika);
- Të shpjegojë afatet, si dhe normat e ujitjes që zbatohen në pemëtoret e reja;

Krasitja

- Të përshkruajë konceptin e krasitjes, faktorët fiziologjikë dhe klimatikë që ndikojnë në cilësinë e krasitjes në drufrutore;
- Të përshkruajë bazat teorike të krasitjes së kulturave drufrutore;
- Të përshkruajë mënyrat e krasitjes sipas: mënyrës së prerjes (shkurtim, rrallim), masës së prerjes (lehtë, normale, rëndë), qëllimit (formuese, prodhuese, ripërtëritëse etj.) dhe kohës së ndërhyrjes (verore, dimërore);
- Të shpjegojë format e ndryshme të mbajtjes së kurorës (të lirë, gjysmë të lirë dhe të detyruar);
- Të përshkruajë krasitjen e pemëve të reja dhe pemëve në prodhim;
- Të shpjegojë kushtet natyrore dhe biologjike në të cilat kryhen krasitjet dimërore dhe ato pranverore në pemët frutore, ulli, agrume etj.;
- Të shpjegojë rregullat dhe teknikat e prerjes që mbahen parasysht në procesin e krasitjes;
- Të shpjegojë realizimin e krasitjeve në pemët frutore, ullishte, agrume etj. sipas specifikave të tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e mirëmbajtjes së pemishteve në prodhim (plotësim boshllëqesh, dendësim, rrallim etj.);

Sëmundjet dhe dëmtuesit e pemëve frutore

- Të shpjegojë sëmundjet dhe ndikim e tyre në prodhimtarinë e kulturave drufrutore;
- Të dallojë sëmundjet parazitare (biotikë) nga ato joparazitare (abiotikë);
- Të përshkruajë shkaktarët e sëmundjeve parazitare (viruset, bakteret, kërpudhat) dhe joparazitare (kushtet e mjedisit- ndriçim, temperaturë, lagështirë, etj.);
- Të përshkruajë përhapjen, shumimin e viruseve dhe sëmundjeve virusale;
- Të përshkruajë përhapjen, shumimin e baktereve dhe sëmundjeve bakteriale;
- Të përshkruajë përhapjen, shumimin e kërpudhave dhe sëmundjeve kërpudhore;
- Të shpjegojë mënyrat e diagnostikimit e të përcaktimit të sëmundjes në kulturat drufrutore;
- Të përshkruajë zhvillimin e procesit patologjik;
- Të analizojë ndryshimet që pëson bima e sëmurë;
- Të shpjegojë dëmtuesit në përgjithësi dhe dëmet që sjellin në pemët frutore;
- Të përshkruajë ndërtimin e trupit të kandrave dhe ciklin jetësor të tyre;
- Të shpjegojë llojin e dëmit që shkaktojnë kandrat;

- Të vlerësohet dëmi i shkaktuar nga dëmtuesit e ndryshëm;
- Të vlerësojë metodat e vrojtimit, prognozimit dhe të sinjalizimit në parandalimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në pemët frutore.

Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve

- Të rendisë metodat e ndryshme të luftimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të përshkruajë metodat kryesore të luftimit të sëmundjeve nga ato të dëmtuesve;
- Të theksojë rëndësinë e zbatimit të metodave agroteknike, të integruar dhe biologjike në luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;
- Të shpjegojë pse metoda kimike e luftimit duhet përdorur me kujdes;
- Të rendisë preparatet kimike që përdoren në pemët frutore;
- Të listojë preparatet kimike që janë me rrezikshmëri më të madhe;
- Të përshkruajë herbicidet nga insekticidet dhe fungicidet, si dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë cilësitë që duhet të kenë pesticidet dhe rregullat e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë sëmundjet kryesore që prekin drufrutorët, agrumet, ullirin dhe hardhinë;
- Të rendisë masat e luftimit ndaj tyre e sëmundjeve dhe dëmtuesve ;
- Të analizojë dëmet që shkaktohen nga dëmtuesit kryesorë në pemët frutore, ullirin, agrumet dhe hardhinë;
- Të shpjegojë mënyrën e saktë të përgatitjes së preparateve kimike të domosdoshëm në luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve.

Vjelja

- Të shpjegojë mënyrën e vlerësimit të prodhimit të prithshëm;
- Të përshkruajë kohën e vjeljes së prodhimit sipas llojeve të ndryshme dhe drejtimit të shfrytëzimit të pemëve frutore, ullinjve, agrumeve;
- Të përshkruajë mënyrat e vjeljes sipas llojeve dhe kultivarëve të pemëve frutore;

Kultivarët e pemëve frutore ullinjve dhe agrumeve

- Të rendisë llojet dhe kultivarët autoktonë dhe të huaj që janë sot në prodhim në vendin tonë;
- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të pemëve frutore farore, bërthamore, arnore;
- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të fikut, hurmës, shegës, manit, hives etj.;
- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të frutave të vogla (luleshtrydhe, mjedra, boronica, manaferra etj.);
- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të ullirit për vaj dhe për ngrënie;
- Të përshkruajë kultivarët kryesorë të agrumeve ;

Vreshtari

- Të përshkruajë faktorët klimatikë (temperaturë, lagështi, dritë) që ndikojnë në zhvillimin e hardhisë;
- Të shpjegojë ndikimin e faktorëve tokësorë në zhvillimin e hardhisë;
- Të shpjegojë ndikimin e mikro-makro gjallesave dhe njeriut në zhvillimin e hardhisë;
- Të shpjegojë klasifikimin botanik dhe ekonomik të hardhisë dhe të bëjë dallimin midis tyre;

- Të përshkruajë rajonizimin e hardhisë në vendin tonë sipas zonave klimatike –tokësore;

Shtimi i hardhisë

- Të shpjegojë mënyrat e shtimit tek hardhia (me farë, vegjetative, përpajë, copa dhe shartim);
- Të argumentojë domosdoshmërinë e prodhimit të fidanëve antifilokserikë;
- Të përshkruajë parimet mbi të cilat mbështetet ngritja e vreshtit mëmë antifilokserik;
- Të përshkruajë shërbimet kryesore që bëhen në vreshtin mëmë antifilokserik;
- Të shpjegojë kushtet që duhet të plotësojnë vreshti mëmë për marrjen e copave për mbishartesat dhe prodhimi i tyre;
- Të shpjegojë etapat e teknologjisë së fidanëve të shartuar antifilokserikë;
- Të shpjegojë përgatitjen e nënshartesës dhe mbishartesës antifilokserike për shartim;
- Të shpjegojë teknikën e shartimit në tryezë të copave antifilokserikë;
- Të shpjegojë proceset e mëtejshme pas shartimit të copave antifilokserike; si (parafinimi, shtratifikimi, kallusimi, kalitja);
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së tokës dhe shartesave për mbjellje;
- Të rendisë mënyrat e mbjelljes (me ledhe, në kuti etj.) të shartesave në shartesore;
- Të rendisë shërbimet që kryhen në shartesore;
- Të shpjegojë procesin e shkulljes së fidanëve dhe trajtimin e tyre pas shkulljes;
- Të përshkruajë mënyrat e shartimit në vend të hardhisë (e thatë, të gjelbra, dhe gjysmë të thata);

Krijimi i vreshtit të ri

- Të tregojë veçoritë e krijimit të vreshtit të ri në vendin tonë;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së tokës përpara mbjelljes së hardhisë;
- Të rendisë mënyrat, kohën, thellësinë e mbjelljes, si dhe shërbimet në vreshtat e rinj;
- Të përshkruajë hallkat kryesore të teknologjisë për të shpejtuar futjen në prodhim të vreshtave të rinj;
- Të shpjegojë qëllimin, rëndësinë dhe bazat teorike të krasitjes;
- Të përshkruajë fazat (formuese, prodhuese dhe ripërtëritëse) të krasitjes tek hardhia;
- Të shpjegojë sistemet e krasitjes tek hardhia;
- Të dallojë ndryshimin midis sistemit të krasitjes dhe formës së trajtimit të hardhisë;
- Të shpjegojë format e ndryshme të krasitjes së shkurtër, të gjatë dhe të përzier;
- Të rendisë llojet kryesore dhe operacionet e krasitjeve të gjelbra;
- Të përshkruajë sistemet e ndryshme të mbështetjes dhe mënyrat e lidhjes që përdoren tek hardhia;
- Të shpjegojë llojet e punimeve të tokës sipas kohës dhe qëllimit (të vjeshtës, pranverës, verës dhe punimeve me karakter periodik);
- Të shpjegojë mënyrat e plehërimit të vreshtave duke i dhënë përparësi plehërimit organik dhe atij të gjelbër;
- Të shpjegojë procesin e ujitjes, luftimin e barërave të këqija, si dhe shëndetësimin dhe rindërtimin e vreshtave;

- Të përshkruajë sëmundjet më të përhapura të hardhisë si: (vrugu, hiri, kalbëzimi i hirtë etj.), si dhe masat e luftimit të tyre;
- Të përshkruajë dëmtuesit kryesorë të hardhisë si: (tenja e rrushit, merimangat, brumbulli i gjelbër, hundëgjati përdredhës i gjetheve, breshkëza etj.), si dhe masat e luftimit të tyre;

Vjelja dhe ruajtja e rrushit

- Të përshkruajë kohën e vjeljes së rrushit sipas drejtimit ekonomik (për tryezë dhe përpunim);
- Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes së rrushit (frigorifer, në gjendje të njomë, dhe me frenja të thata etj.);
- Të dallojë kultivarët e rrushit për tavolinë;
- Të dallojë kultivarët e rrushit për verë të bardhë dhe të kuqe;
- Të dallojë kultivarët e rrushit për tharje;

Përpunimi i frutave

- Të përshkruajë vlerat ushqyese të frutave dhe rolin e tyre në organizëm;
- Të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme të frutave që do të përpunohen;
- Të klasifikojë frutat për lloje të ndryshme të përpunimit si: lëngje, komposto, reçel, marmelatë e fruta të thata;
- Të përshkruajë mënyrat e ruajtjes së frutave farore, bërthamore, agrumeve, ullinjve;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të lëngjeve, kompostos, reçelit, marmelatës dhe prevedesë në fruta të ndryshëm;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të frutave të thata;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të verës së kuqe dhe të bardhë;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të rakisë nga rrushi dhe fruta të tjerë;
- Të klasifikojë verërat sipas kritereve të përcaktuara;
- Të përshkruajë teknologjinë e përpunimit të agrumeve;
- Të përshkruajë teknologjinë e përgatitjes së lëngut të agrumeve;
- Të përshkruajë teknologjinë e përpunimit të ullirit për vaj;
- Të përshkruajë teknologjinë e prodhimit të ullirit për ngrënie.

Planifikimi, organizimi dhe tregtimi i produkteve të kulturave drufrutore

- Të shpjegojë rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit me drejtim frutikulturë dhe rolin e tyre në ekonomi;
- Të përshkruajë një plan-projekt për një ferme që prodhon kultura drufrutore;
- Të shpjegojë organizimin e punës në një fermë të vogël me drejtim frutikulturë;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajë karakteristikat e konsumatorëve vendas dhe të huaj;
- Të shpjegojë procedurat për hapjen e një ekonomie bujqësore me drejtim frutikulturë;
- Të rendisë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në ngritjen e një ekonomie bujqësore me drejtim frutikulturë;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë e shpërndarjes së produkteve të kulturave drufrutore;
- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të kontratave të shit-blerjes;

- Të shpjegojë kuptimin e bankave, institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të kulturave drufrutore;
- Të analizojë kostot e prodhimit dhe shërbimit në frutikulturë;
- Të përshkruajë nevojën e hartimit të një preventivi për produktet e kulturave drufrutore;
- Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve për fermën me drejtim frutikulturë;
- Të shpjegojë dokumentacionin financiar dhe teknik për punimet në frutikulturë;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve dhe bashkëpunimit me biznese të suksesshme me drejtim frutikulturë në vend dhe jashtë saj;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik në punë;
- Të përshkruajë pajisjet mbrojtjes individuale gjatë trajtimeve në frutikulturë;
- Të përshkruajë kërkesat e sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;
- Të theksojë masat mbrojtëse që duhen të merren për parandalimin e helmimit nga preparatet kimike;
- Të përzgjedhë mënyrën e dhënies së ndihmës së shpejtë personave të helmuar nga pakujdesia gjatë përgatitjes dhe përdorimit të tretësirës;
- Të vlerësojë masat e sigurimit teknik ndaj përdorimit dhe ruajtjes së preparateve kimike;
- Të përshkruajë llojet e mbetjeve në industrinë e prodhimit të produkteve të përfuara nga përpunimi i frutave;
- Të vlerësojë masat për mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi pa kriter i kimikateve.

Legjislacioni

- Të listojë aktet ligjore e normative, që rregullojnë veprimtarinë e frutikulturës;
- Të përshkruajë aktet ligjore dhe normative në fuqi për prodhimtari dhe tregtim të materialit shumues në frutikulturë;
- Të rendisë procedurat e certifikimit të materialeve të shumimit;
- Të përshkruajë standardet (SSH³) e materialeve të shumimit dhe prodhimit të fidanëve;
- Të përshkruajë standardet e profesionit të kultivuesit të drufrutorëve;
- Të përshkruajë normativat ligjore lidhur me punësimin, sigurimet, shpërblimin dhe mbrojtjen në punë;
- Të përshkruajë normativat bazë ligjore për konkurrencën në treg për produktet bujqësore;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij;
- Të përshkruajë elementet bazë të legjislacionit të pronësisë;
- Të argumentojë domosdoshmërinë e respektimit dhe forcimit të legjislacionit mbi mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri;

³Standarti Shqiptar

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Pemët frutore, ullishtë dhe agrume

- Të seleksionojë llojet e kultivarëve të ndryshëm të pemëve frutore, ullinj dhe agrume;
- Të grumbullojë fara të pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve për prodhimin e filizave;
- Të grumbullojë material shumimi (fara, copa kërcellore dhe rrënjore) për prodhimin e fidanëve të fikut, hurmës, shegës, hides;
- Të seleksionojë kultivarët e ndryshëm vendas të ullinjve për vaj dhe ngrënie;
- Të grumbullojë fara për prodhimin e filizave që do shartohen;

Shartimi në drufrutorët

- Të kryejë shartim me sytha të fjetur, të zgjuar, në formë unaze të pemët frutore, agrumet;
- Të kryejë shartim me kalem me çarje të plotë dhe çarje anësore tek kulturat drufrutore;
- Të kryejë shartimin me kalema (nën lëvore) te ulliri;
- Të kryejë shartim me kopulim në farore dhe te arrorët;
- Të kryejë rishartimin e bimëve në raste se shartimi nuk ka zënë;
- Të kryejë shërbime në bimët të porsa shartuara, për të dhënë një bimë të re të shëndetshme;

Fidanishtja e pemëve frutore

- Të përcaktojë kushtet klimatike dhe teknologjike për ngritjen e fidanishtes;
- Të tregojë hallkat teknologjike për prodhimin e fidanëve frutorë;
- Të ndërtojë sektorët e pemëtores mëmë të (nënshartesave dhe mbishartesave);
- Të përcaktojë kushtet që duhet të plotësojë vendi ku do të mbillet nënshartesa;
- Të përcaktojë sektorët kryesorë të realizimit të fidanëve, si dhe rolin e secilit sektor (mëmë, shtimit, formimit);
- Të kryejë mbjelljen e farës për prodhimin e nënshartesave në pemët frutore, agrume dhe ullishta;
- Të tregojë cilësitë që duhet të ketë fara që përdoret për nënshartesë;
- Të tregojë hapat e përgatitjes së farës (nxjerrja, tharja, zgjedhja, ruajtja, shtratifikimi dhe mbjellja në farishte);
- Të kryejë përgatitjen e tokës për mbjelljen e farës;
- Të kryejë mbjelljen e farës për prodhimin e nënshartesave në pemët frutore, agrume, ullishta;
- Të kryejë shërbimet në farishte pas mbjelljes së farës;
- Të përzgjedhë sektorin mëmë për marrje kalemash për mbishartesë;
- Të organizojë sektorin e shtimit sipas mënyrës dhe qëllimit të shtimit;
- Të kryejë shartimin e filizave;
- Të organizojë sektorin e formimit ose shartesores sipas viteve që mbahen fidanët në shartesore;
- Të kryejë shërbimet agroteknike në shartesoren e vitit të parë, të dytë dhe të tretë;
- Të kryejë teknikën e shkuljes dhe klasifikimit të fidanëve të prodhuar me farë;

- Të kryejë shtratifikimin e fidanëve;
- Të kryejë seleksionimin, etiketimit, ambalazhimit dhe transportit të fidanëve;
- Të përzgjedhë pjesët vegjetative të pemëve frutore, ullirit dhe agrumet;
- Të ndërtojë shartesoreve të vitit të parë, të dytë dhe të tretë për të prodhuar fidanë me pjesë vegjetative të pemëve frutore dhe ullirit;
- Të kryejë shërbime në shartesoren sipas viteve për prodhimin e fidanëve ;
- Të kryejë shkulljen, përzgjedhjen, klasifikimin, etiketimit, shtratifikimin, ambalazhimin dhe transportin e fidanëve të pemëve frutorë të prodhuar me pjesë vegjetative;
- Të realizojë krasitje të kurorës së pemëve frutore ullirit dhe agrumeve;
- Të kryejë trajtimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të fidanëve në fidanishte;

Krijimi i pemëtoreve të reja

- Të zbatojë projektet teknik të thjeshta, për ngritjen e blloqeve të reja me pemëtore;
- Të përcaktojë faktorëve klimatikë dhe tokësorë në ngritjen të pemëtoreve të reja;
- Të tregojë elementët kryesorë të organizimit të territorit;
- Të kryejë sistemimin sipërfaqësor në krijimin e bllokut të pemëtoreve;
- Të zbatojë hapat teknologjikë të punimeve para mbjelljes së fidanit;
- Të kryejë piketimit të tokës në formë katrori, trekëndëshi, katërkëndëshe dhe vijave rrushkulluese, në përshtatje me kushtet klimatiko-tokësore të zonës ku ngrihet blloku i pemëtoreve, ullishtave etj.;
- Të kryejë mbjelljen e fidanëve sipas formave (katrore, trekëndësh, katërkëndësh dhe vijave rrushkulluese);
- Të kryejë shërbimet menjëherë pas mbjelljes;

Agroteknologjia e pemëtoreve të reja

- Të kryejë shërbimet e pemëtoreve të reja në vitet e para;
- Të kryejë punimin e tokës në pemishte në vitet e para pas mbjelljes (ugar, livadh, mulçerim etj.);
- Të kryejë bashkëshoqërimin e pemëtoreve me bimë të tjera, si dhe bashkëshoqërueset më të përshtatshme, sipas llojit të pemëve;
- Të kryejë e punimet e vazhdueshme të tokës në pemëtore;
- Të kryejë shërbimet e duhura për luftimin e barërave të këqija me punim toke, shkullje me dorë, dhe herbicide;
- Të kryejë plehërimin organik, mineral dhe të gjelbër në pemëtore;
- Të kryejë ujitje (me tava, shiu dhe me pika);
- Të llogarisë normat e ujitjes që zbatohen në pemëtoret e reja;

Krasitja e drufrutorëve ullirit dhe agrumeve

- Të kryejë krasitjet dimërore dhe verore të pemëve të reja dhe ato në prodhim
- Të kryejë krasitje në formë kupore te pemët frutore farore ;
- Të kryejë krasitje në formë kupore dhe piramidale në pemët frutore bërthamore ;
- Të kryejë krasitje në formë kupore- shkurore, kupore- globoze dhe palmet te ulliri ;

- Të kryejë krasitje në formë kupore- globoze te agrumet ;
- Të realizojë krasitje në forma palmete te molla, dardha dhe agrumet;

Shërbimet në frutikulturë

- Të kryejë punimet bazë dhe plotësuese për mbjelljen e pemëtores;
- Të kryejë plehërime bazë dhe plotësuese në pemëtore, ullishte dhe agrumishte;
- Të kryejë mbjelljen e fidanëve të pemëve frutore sipas skemave të mbjelljes;
- Të kryejë zëvendësimin e fidanëve në pemëtore;
- Të kryejë shërbimet agroteknike në pemëtore të reja dhe ato në prodhim;
- Të kryejë punimin për rreth kurorës së pemëve me mjete të thjeshta;
- Të realizojë plehërimin e pemëtores me plehra organike dhe minerale me mjete të mekanizuara;
- Të përgatisë tretësirë kimike për trajtimin shëndetësor të pemëve frutore ullirit dhe agrumeve;
- Të kryejë trajtimet kimike për mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit e ndryshëm;
- Të realizojë mirëmbajtjen e pemëtoreve, ullishtave, agrumeve, të cilat janë në prodhim;
- Të pastrojë dhe mirëmbajë mjedisin në pemëtore, ullinj, agrume;

Vreshtari

- Të realizojë shtimin e hardhisë me përpaja;
- Të kryejë mbjelljen me copa të hardhisë;
- Të përzgjedhin disa nënshartesa antifilokserik që përdoren në vendin tonë;
- Të kryejë shartim me syth dhe kalema të hardhisë ;
- Të përgatisë tokën për mbjelljen e shartesave të hardhisë;
- Të kryejë mbjelljen e shartesave në shartesore;
- Të kryejë shërbimet në shartesore (në vitin e I, II, III) dhe të shkulë fidanët e hardhisë;
- Të pastrojë dhe sistemojë territorin për ngritjen e një vreshti të ri;
- Të kryejë punimin dhe plehërimin e tokës për mbjelljen e vreshtit;
- Të kryejë piketimin e tokës për mbjelljen e vreshtit;
- Të mbjellë fidanë hardhish të shartuar e të rrënjëzuar;
- Të kryejë punimin e vazhdueshëm në vreshta;
- Të realizojë forma të ndryshme krasitje dimërore dhe verore në vreshta :
- Të realizojë sisteme mbështetje në vreshta;
- Të kryejë shërbimet gjatë vegjetacionit në vreshta;
- Të kryejë trajtimet për shëndetësimin e vreshtit;
- Të vjelë prodhimin e vreshtit sipas procedurave të caktuara;
- Të ruajë prodhimin e rrushin për tavolinë dhe verë, sipas kushteve të duhura teknike;
- Të selekcionojë kultivarët e rrushit për tavolinë, verë dhe tharje.

Mbrojtje bimësh

- Të organizojë këndin për sektorin e vrojtimit prognoz-sinjalizimit;
- Të kryejë vëzhgimin e vazhdueshëm të kulturave në frutikulturë për parandalimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve;

- Të përcaktojë saktë sëmundjet apo dëmtuesit e kulturave drufrutore;
- Të vrojtojë llojet e sëmundjeve në drufrutorë të ndryshëm;
- Të praktikojë masat agroteknike të integruara dhe biologjike në luftimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve në drufrutorë të ndryshëm;
- Të kryejë luftimin e barërave të këqija me metoda agroteknike;
- Të përdorë tretësira të pesticideve të lejuara për trajtime kimike në frutikulturë sipas udhëzimeve;
- Të kryejë spërkatjen e kulturave drufrutore sipas standardit;
- Të kryejë trajtimin me herbicide për luftimin e barërave të këqija në frutikulturë sipas udhëzimeve;
- Të pastrojë dhe mbrojë mjedisin gjatë trajtimeve kimike të bimëve;

Vjelja

- Të llogarisë prodhimin e pritshëm në pemëtore;
- Të përcaktojë kohën e vjeljes së prodhimit sipas llojeve të ndryshme dhe drejtimit të shfrytëzimit të pemëve frutore, ullinjve dhe agrumeve;
- Të kryejë vjeljen frutave sipas llojeve të kultivarëve të pemëve frutore, ullirit dhe agrumeve;

Kultivarët e pemëve frutore ullinjve dhe agrumeve

- Të përzgjedhë llojet dhe kultivarët autoktonë dhe të huaj që janë sot në prodhim në vendin tonë;
- Të përzgjedhë kultivarët kryesorë të pemëve frutore farore, bërthamore, arnore;
- Të përzgjedhë kultivarët kryesorë të fikut, hurmës, shegës, manit, hides etj.;
- Të përzgjedhë kultivarët kryesorë të frutave të vogla (luleshtrydhe, mjedra, boronica, manaferra etj.);
- Të përzgjedhë kultivarët kryesorë të ullirit për vaj dhe për ngrënie;
- Të përzgjedhë kultivarët kryesorë të agrumeve;

Përpunimi i frutave

- Të vjelë dhe ambalazhojë prodhimet e frutave të freskëta në drufrutorë të ndryshëm;
- Të përgatisë komposto me fruta të ndryshëm;
- Të përgatisë reçel me fruta të ndryshëm;
- Të përgatisë lëngje me fruta të ndryshëm;
- Të përgatisë uthull me fruta të ndryshëm;
- Të prodhojë raki me fruta të ndryshëm;
- Të përgatisë pekmez;
- Të përgatisë marmelatë me fruta të ndryshëm;
- Të përgatisë fruta të ndryshëm të thata;
- Të konservojë ullirin për ngrënie;
- Të prodhojë vaj ulliri;

Planifikimi, organizimi dhe tregtimi i produkteve të kulturave drufrutore

- Të organizojë punën në një fermë të vogël me drejtim frutikulturë;

- Të zbatojë procedurat e regjistrimit për hapjen e një ferme të vogël me drejtim frutikulturë;
- Të mbledhë informacionin e duhur për konsumatorë vendas dhe të huaj;
- Të vendosë dhe ruajë marrëdhëniet me furnitorët dhe klientët;
- Të respektojë dhe plotësojë dëshirat dhe nevojat e klientit;
- Të komunikojë me gjuhën e duhur me klientin;
- Të kryejë përpunimin e produkteve të kulturave drufrutore;
- Të përzgjedhë pajisjet paketuuese të përdorura në përputhje me kriteret e cilësisë;
- Të zbatojë rregulloret për paketimin e prodhimit të produkteve të kulturave drufrutore;
- Të kryejë etiketimin dhe ambalazhimin e produkteve të kulturave drufrutore sipas standardeve;
- Të kryejë magazinimin e produkteve të kulturave drufrutore;
- Të përgatisë produktin për shpërndarje;
- Të kontrollojë cilësinë e produktit sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në përpunimin dhe realizimin e fushatave të thjeshta të reklamave;
- Të promovojë produktet e kulturave drufrutore;
- Të llogarisë kostot dhe çmimin e produkteve të kulturave drufrutore;
- Të llogarisë vlerën e dëmit të shkaktuar nga sëmundje të ndryshme në frutikulturë;
- Të përpilojë dhe plotësojë saktë një faturë shit-blerjeje duke pasur në konsideratë të gjitha elementet e faturës;
- Të kryejë tregtimin e produkteve të kulturave drufrutore;
- Të administrojë dokumentacionin e blerjeve dhe shitjeve;
- Të llogarisë të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatin e ekonomisë bujqësore me drejtim frutikulturë;
- Të plotësojë të dhënat për blerjet dhe shitjet duke përdorur programe kompjuterike;
- Të përdori Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve me ferma të suksesshme me drejtim frutikulturë, vendase dhe të huaja;

Mjetet dhe pajisjet e punës

- Të përdorë mjetet e punës për punimin e tokës në pemëtari, ullishte dhe agrume;
- Të përdorë veglat pajisjet dhe materialet e nevojshme për shartim drufrutorëve;
- Të përdorë veglat pajisjet dhe materialet e nevojshme për krasitjen e drufrutorëve;
- Të përdorë pajisjet dhe materialet e nevojshme për trajtimin kimik të drufrutorëve;
- Të përdorë mjetet e nevojshme për procesin e përpunimi frutave;

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë shërbimeve të ndryshme në frutikulturë;
- Të sigurojë veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e shërbimeve në frutikulturë;
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe makineritë e thjeshta, për proceset e ndryshme të punës në frutikulturë;
- Të organizojë vendin e punës për kryerjen e të gjitha punimeve në frutikulturë;
- Të përdoren pesticide të paketuara, ambalazhuara dhe të lejuara, sipas standardit;
- Të kryejë transportin dhe ruajtjen e pesticideve larg njerëzve, kafshëve dhe ushqimeve;

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së shëndetit, si dhe ato të ruajtjes së mjedisit gjatë spërkatjeve në frutikulturë;
- Të veshin uniformën dhe të vendosin maskat mbrojtëse gjatë trajtimeve kimike në frutikulturë;
- Të vendosë tabelat lajmëruese për rrezikun nga helmi në parcelat e trajtuara me pesticid;
- Të grumbullojë dhe asgjësojë mbeturinat dhe ambalazhet e boshatisura në vende të sigurta;
- Të pastrojë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe makineritë e thjeshta të përdorura për proceset e ndryshme të punës në frutikulturë.

Legjislacioni

- Të zbatojë aktet ligjore e normative, që rregullojnë veprimtarinë e frutikulturës;
- Të zbatojë aktet ligjore dhe normative në fuqi për prodhimtari dhe tregtim të materialit shumues;
- Të zbatojë procedurat e certifikimit të materialeve të shumimit;
- Të zbatojë standardet (SSH⁴) e materialeve të shumimit dhe prodhimit të fidanëve;
- Të zbatojë standardet e profesionit të kultivuesit të drufrutoreve;
- Të zbatojë normativat ligjore lidhur me punësimin, sigurimet, shpërblimin, dhe mbrojtjen në punë;
- Të zbatojë normativat bazë ligjore për konkurrencën në treg për produktet e kulturave drufrutore;
- Të zbatojë legjislacionin mbi pronësinë;
- Të respektojë legjislacionin mbi mbrojtjen e mjedisit gjatë shërbimeve të ndryshme që kryhen në frutikulturë;

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.

⁴Standarti Shqiptar

- Të organizojë drejt procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

–